



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 60/03 dhe 114/2009), përveç kompetencave tjera, Avokati i Popullit ka autorizim të monitorojë se a respektohen dhe mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat kufizohet liria e lëvizjes.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional ka mandat të përcaktuar me Protokollin Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore ose Nënçmuese, i cili i mundëson të kryej vizita në vendet e privimit nga liria dhe vendet e ndalimit, si dhe përmes kontrollit të kushteve materiale dhe trajtimit t’i identifikojë rreziqet me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të tajmit brutal, jonjerëzor dhe ndëshkues.

Konform autorizimeve, më datë **06.10.2016**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor Çair, me ç’rast realizoi takime me personat përgjegjës zyrtarë. Vizita në stacionin policor filloi në ora 11:00, ndërsa përfundoi në ora 15:00 (kohëzgjatja e përgjithshme 4 orë).

Vizita në stacionin policor u zbatua në atë mënyrë që përfshiu bisedën me komandantin e stacionit policor, zëvendësin dhe ndihmës komandantët, u zbatua këqyrje në hapësirat zyrtare dhe në brendësinë e stacionit policor, këqyrje të regjistrave (për ngjarje ditore, regjistron për personat e thirrur, të arrestuar dhe ndaluar, regjistrin për përdorimin e mjeteve të dhunës, regjistrin për parashtresa të qytetarëve), këqyrje mbi dosjet e disa personave të ndaluar dhe të arrestuar, këqyrje të automjeteve të transportit, si dhe biseda me personat zyrtarë, përgjegjës in e turnit të stacionit policor, si dhe me inspektorë të seksionit për delikte pronësore dhe delikuencën e të miturve.

Nga biseda me komandantin, MPN-ja u informua lidhur me rajonin në të cilin vepron Stacioni Policor Çair, i cili është kompetent për vendbanimet: Butel, Shuto Orizarë dhe Çuçer Sandevë në të cilat, sipas informacioneve të regjistrimit, nga viti 2002, jetojnë rreth 69 880 banorë.

Përveç Stacionit Policor në Çair funksionon edhe seksioni policor në Mirkovci, ku janë angazhuar 19 nëpunës policorë.

Me vendim të SPB Shkup, Stacioni Policor Çair tanimë nuk përdoret si stacion në të cilin ndalohen personat, por të gjithë personat të cilët duhet të ndalohet dërgohen në SP Gazi Babë dhe SP Bit Pazar.

Përshtypje e përgjithshme, lidhur me kushtet materiale të SP Çair, është se stacioni policor gjendet në një barakë të vjetër dhe të amortizuar e cila ndahet në dy pjesë, pjesën përdhese dhe pjesën e bodrumit dhe i njëjti funksionon në kushte mjaft të këqija.

Gjatë vizitës u konstatua se të drejtat janë theksuar në zyrën e përgjegjës të turnit dhe në korridor edhe pse, siç informuan edhe ata vet, menjëherë i njoftojnë gojarisht personat e privuar nga liria.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative, si dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe komandantit të Stacionit të Policisë Çair me qëllim të shmangies së mangësive të identikuara.